

Vaksina BCG (Bacille Calmette- Guérin)

Kjo ndihmon në mbrojtjen kundër tuberkulozit. Kjo është një forcë e dobësuar e një forme të bakterit të tuberkulozit, e cila nuk shkakton sëmundje. Ajo e nxit trupin ta luftojë sëmundjen e tuberkulozit duke rritur imunitetin. Ndërkohë që BCG-ja mund të ofrojë mbrojtje kundër tuberkulozit, ajo nuk mund t'i mbrojë të gjithë personat të cilëve u jepet.

Që prej ndryshimeve në programin BCG në vitin 2005, ajo nuk ofrohet më vazhdimisht për fëmijët në shkollat e mesme në Mbretërinë e Bashkuar. Ajo është zëvendësuar me një program të synuar për foshnjat, fëmijët dhe të rinjtë me rrezik më të lartë tuberkulozi (TB).

Cilët persona kanë nevojë ta marrin BCG-në?

Rekomandimet e Departamentit të Shëndetësisë janë:

- Të gjitha foshnjat nën 12 muajsh, si të lindura ashtu edhe që jetojnë në zona me një numër më të madh rastesh (d.m.th. më shumë se 40 raste tuberkulozi në vit për 100 000 persona), ashtu dhe ato që kanë një prind ose gjysh që ka lindur ose ka ardhur nga një vend i tillë. *Mamia juaj ose inspektori i shëndetit duhet të caktojë një BCG nëse fëmija juaj i përket asaj kategorie. Ju duhet të flisni me ta nëse keni ndonjë pyetje.*

- Fëmijët më të rritur që nuk kanë marrë BCG-në, mund të ekzaminohen për faktorët e rrezikut të tuberkulozit dhe nëse është e nevojshme të testohen dhe të vaksinohen. Faktorët e rrezikut vijnë zakonisht ose nga një vend ku ka një numër të madh rastesh, ose duke pasur një prind ose gjysh që ka lindur ose ka ardhur nga një vend i tillë. *Ju lutemi, kërkojini inspektorit të shëndetit, infermieres ose mjekut të familjes të kërkojë këshilla nga Koordinatori i Imunizimit nëse ndjeni se fëmija juaj përballat me një rrezik të madhe dhe se ai nuk është vaksinuar.*

Ekzistojnë grupe të tjera të veçanta individësh të cilët mund të jenë gjithashtu të ekspozuar shumë ndaj rrezikut të tuberkulozit.

- Kontaktet e afërta me personat e diagnostikuar me tuberkuloz në mushkëri. *Nëse ju i përkisni kësaj kategorie, ju do të identifikoheni dhe do të kontaktoheni nga shërbimet e shëndetit publik*
- Grupet profesionale, si p.sh. ato që punojnë në shëndetësi, me të moshuarit, në strehimet për të pastrehët dhe refugjatët, stafi laboratorik, stafi i burgut dhe stafi veterinar. *Nëse ju i përkisni njërit nga këto grupe, jeni nën 35 vjeç (studimet sugjerojnë që BCG-ja ka një ndikim më të ulët te personat mbi 35 vjeç) dhe nuk jeni vaksinuar më parë, ju duhet të kontaktoni departamentin e shëndetit profesional ose atë të personelit rreth BCG-së.*

- Individët nën 16 vjeç që do të jetojnë me një popullatë vendase për më shumë se tre muaj në një shtet që ka një numër të lartë rastesh me tuberkuloz. *Nëse ju i përkisni këtij grupi dhe nuk jeni vaksinuar më parë, ju mund të keni nevojë për BCG-në, por nuk keni mundësi ta bëni vaksinimin te NHS. Juve mund t'ju duhet ta kryeni BCG-në në mënyrë private për udhëtimin. Shikoni më poshtë për më shumë hollësi.*

Por më duhet BCG-ja, pra a mund ta marr akoma?

Nëse ju nuk i përkisni asnjërit nga grupet e afishuara, BCG-ja nuk rekomandohet dhe ju nuk do të mund ta merrni atë te NHS-ja.

BCG-ja për udhëtime

BCG-ja nuk rekomandohet si një vaksinë për udhëtime të zakonshme.

Fëmijët nën 16 vjeç që do të jetojnë me popullatën lokale në një vend me një numër të madh rastesh me tuberkuloz për më shumë se tre muaj dhe nuk e kanë marrë më parë BCG-në, këshillohen të bëjnë një test lëkure për të parë nëse nevojitet BCG-ja.

Zakonisht, BCG-ja për udhëtime dhe testimi për të do të duhet të kryhet në mënyrë private. Disa klinika për udhëtime e ofrojnë këtë shërbim por çmimet ndryshojnë dhe është një ide e mirë të telefononi dhe të njiheni paraprakisht me koston. Klinikat për udhëtime MASTA gjenden në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar dhe disa, megjithëse jo të gjitha, e ofrojnë BCG-në. Ju mund ta gjeni klinikën tuaj më të afërt duke hyrë në faqen e tyre të internetit në www.masta.org.

Nëse jetoni në Londër, klinikat e quajtura MediCentre të pozicionuara në pjesën më të madhe të stacioneve kryesore hekurudhore e ofrojnë gjithashtu BCG-në. Adresa e tyre e internetit është www.medicentre.co.uk ose ju mund t'i telefononi ato në numrin 0870 600 0870. Nëse keni vështirësi në gjetjen e një klinike që e ofron këtë shërbim, telefonojini TB alert-it në 0845 456 0995 për më shumë informacion.

Çfarë është tuberkulozi?

Tuberkulozi është një infeksion bakterial që zakonisht dëmton mushkëritë por që mund të dëmtojë çdo pjesë të trupit. Tuberkulozi është i mjekueshëm nëpërmjet një cikli mjekimi që zgjat zakonisht 6 muaj. Vetëm tuberkulozi i mushkërive ose i fytyrit mund të jetë infektues dhe pjesa më e madhe e njerëzve nuk do të jenë infektues brenda dy javëve nga fillimi i marrjes së barnave të duhura.

Si merret tuberkulozi?

Kur dikush me tuberkuloz infektues të mushkërive ose të fytyrës kollitet ose teshtin, mikrobet mund të përhapen në ajër në formën e pikëzave dhe njerëzit e tjerë mund t'i marrin me anë të frymëmarrjes. Njerëzit që kanë më shumë gjasa që të infektohen me tuberkuloz, janë ata të cilët kanë kaluar një kohë të gjatë pranë personave me tuberkuloz (zakonisht partnerët dhe njerëzit e tjerë brenda një shtëpie, ose shumë rrallë kolegët e afërt të punës). Ka shumë pak mundësi që dikush të mund të infektohet me tuberkuloz në vende të tilla si p.sh. në autobus ose në tren, meqë për të qenë i rrezikuar nga infektimi është i domosdoshëm kontakti për një numër të caktuar orësh medikë që është i infektuar. Tuberkulozi nuk

përhapet nëpërmjet pështymës ose shkëmbimit të objekteve. Në Mbretërinë e Bashkuar, personat më të rrezikuar për zhvillimin e tuberkulozit janë ata të cilët:

- kanë qenë për një kohë të gjatë me një rast të infektuar;
- kanë jetuar në vende ku tuberkulozi është ende i zakonshëm;
- kanë një sistem imunitar të dobësuar nga HIV ose ndonjë kusht tjetër mjekësor
- kanë një shëndet të dobët kronik si pasojë e faktorëve socialë, si p.sh. mungesa e strehimit, alkoolizmi dhe abuzimi me drogën.

Fëmijët e vegjël dhe personat shumë të moshuar kanë gjithashtu më shumë gjasa për të zhvilluar sëmundjen e tuberkulozit sesa popullata e përgjithshme.

Ekziston një dallim i madh mes infektimit dhe sëmundjes aktive; personat mund të infektohen por jo të sëmuren (ky quhet infektim me tuberkuloz të fshehur), meqenëse sistemet e imunitetit të shumicës së personave arrijnë t'i parandalojnë bakteret të aktivizohen. Vetëm tuberkulozi aktiv është shumë infektues.

Nuk kam marrë vaksinë BCG kur kam qenë i vogël - a duhet ta marr tani që tuberkulozi po përhapet në Mbretërinë e Bashkuar?

Përpara vitit 2005, kur përfundoi programi i BCG-së për shkollat, shumica prej nesh do e kishte marrë vaksinën BCG në shkollë kur kemi qenë rreth 13 vjeç. Nëse ju nuk e keni marrë vaksinën (rreth 30% prej nesh nuk e kanë marrë), nuk do të kishte shumë efekt po ta merrnim tani. BCG-ja mendohet të jetë efikase rreth 15 vjet dhe studimet na sugjerojnë se ajo ka një ndikim të vogël nëse jepet për herë të dytë dhe ka një efekt të vogël te personat mbi 35 vjeç. Rreziku i infektimit me tuberkuloz për shumicën e njerëzve është akoma shumë i vogël dhe mënyra më e mirë për ta parandaluar tuberkulozin është mjekimi i personave që janë të infektuar me të në mënyrë që ai të ndalet.

Si kryhet një vaksinim me BCG?

Së pari, kryhet një test lëkure për të parë reagimin e sistemit imunitar ndaj bakterit të tuberkulozit. Zakonisht, për fëmijët nën moshën 6 vjeç, nuk ka nevojë për test përpara vaksinimit, përveç rasteve kur ata kanë patur kontakt të afërt me personat me tuberkuloz infektiv ose nëse kanë jetuar për më shumë se tre muaj në një shtet me një numër të lartë rastesh me tuberkuloz. Testi i lëkurës quhet Test Mantoux dhe është një injektim i vogël në shtresat e sipërme të lëkurës. Kjo mund të djegë pak, por zakonisht dhimbja nuk zgjat shumë. Ekzistojnë gjithashtu dy lloje të tjera testesh të gjakut të cilat mund të përdoren dhe teste të tjera në zhvillim.

Kur bëni një test lëkure, pas disa ditësh nevojitet një vizitë tjetër në klinikë, në mënyrë që të lexohet reaksioni në lëkurë dhe më pas, BCG-ja mund të jepet pas tre muajsh nga marrja e një rezultati negativ të testit të lëkurës. Vaksina jepet si një injektim në lëkurën e pjesës së sipërme të krahut. Fillimisht, do të mbetet një ënjtje e vogël që duhet të zhduket në 4-6 orë.

Çfarë ndodh pas injektimit të BCG-së?

Vendi i injektimit do të mbetet i mavijosur për disa ditë, por zakonisht nuk mund të shihet shumë në këtë fazë. Kjo nuk ka gjasa që t'i bëjë njerëzit të ndihen të sëmurë ose me temperaturë.

Pas rreth dy javësh do të krijohet një kokërr në vendin e injektimit. Kjo mund të zhvillohet në një ënjtje ose puçërr të vogël që mund të rrjedhë. Ju lutemi, mos e shtypni atë! Lëreni atë të marrë ajër, sepse kjo do të ndihmojë të shërohet. Përpiquni të mos hiqni koren që mund të jetë formuar. Ndonjëherë, mund të jetë e nevojshme ta mbulonit atë me një copë të thatë. Larja, futja në vaskë dhe noti mund të kryhen normalisht, por duhet të bëni kujdes kur të fshiheni në atë zonë. Që ajo zonë të shërohet, do të duhen rreth 8 javë nga koha e vaksinimit.

Një vrugë e vogël në formë rrethi mund të mbetet në pjesën e sipërme të krahut. BCG-së i duhet rreth gjashtë javë për të ngritur një reagim të imunitetit ndaj tuberkulozit.

Pasi të jepet BCG-ja, në atë krah nuk duhet të jepet asnjë imunizim për 3 muaj. BCG-ja më së miri duhet të jepet në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera me mikrob të gjallë (vaksinat me mikrob të gjallë përfshijnë vaksinën e BCG-së, vaksinën e fruthit, të shytave, të rubeolës dhe vaksinë e kombinuar të të trejave). Sidoqoftë, nëse ato nuk jepen në të njëjtën kohë, rekomandohet një shtyrje prej 4 javësh ndërmjet vaksinave me mikrob të gjallë.

Njoftojeni doktorin ose infermieren tuaj përpara se të bëni një test lëkure ose BCG nëse jeni/keni një nga të mëposhtmet

- E dini se jeni bartës i virusit HIV
- Keni një sëmundje serioze
- Keni anamnezë të kaluar ose aktuale të tuberkulozit
- Përdorni sistematikisht steroide
- Keni patur një test lëkure pozitiv të tuberkulozit në të kaluarën
- Keni marrë një vaksinë me mikrob të gjallë brenda 4 javëve të fundit
- Keni marrë më parë një vaksinë BCG
- Jeni shtatzënë ose duke dhënë gj
- Keni temperaturë të lartë ose ethe
- Mononukleozë ose çfarëdolloj infeksioni viral
- Gjendje e përgjithshme e infektuar e lëkurës

Është e rëndësishme të mbani shënim vaksinimin me BCG për referencë mjekësore në të ardhmen.

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë në MB për tuberkulozin në mbarë botën.

Ne mbështesim projekte në MB dhe në vendet në zhvillim duke siguruar që një numër më i madh pacientësh të marrin informacionin dhe trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj ne mund të krijojmë një ndikim pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



TB Alert

Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert** ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

Simptomat më të zakonshme të tuberkulozit përfshijnë:

- Kollë që zgjat më shumë se tre javë, që nuk reagon ndaj barnave normale dhe përkeqësohet
- Ethe (temperaturë e lartë)
- Djersitje aq e madhe gjatë natës saqë duhet të ndërroni çarçafët
- Humbje e peshës pa asnjë arsye
- Lodhje (mungesë energjie ose lodhje e tepërt)
- Gjëndra të ënjtura
- Kollë me gjak (kjo ndodh shumë rrallë por kërkon këshillim të menjëhershëm mjekësor)

Të gjitha këto simptoma mund të jenë shenja të problemeve të tjera, por nëse ju keni tre ose më shumë nga ato dhe jeni të shqetësuar, ju duhet të flisni me një doktor ose me një infermiere në ambulancën ose në klinikën tuaj lokale.



Tuberkulozi (TB) dhe vaksina BCG

... e madhe gjatë natës
Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës
Temperaturë!!
Humbje e pashpjegueshme në peshë
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Me ose pa kollë
Gjëndra të ënjtura
Temperaturë!!
Temperaturë!!
Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës
Gjëndra të ënjtura
Gjëndra të ënjtura
Temperaturë!!
Humbje e pashpjegueshme në peshë
Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës
Djersitje e madhe gjatë natës
Me ose pa kollë